



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR**  
**SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,240.00€**, (nëntë mijë e dyqind e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-15229 e datës 01.04.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 33 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin mars të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast  $33 \times 280 = 9,240.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

**Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

INr.400/04-15229  
Lipjan, më 02.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK me Nr.15-400/01-9575 të datës 28.02.2025 si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit 1Nr.320/01-8402 të datës 21.02.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, Kryetari i Komunes, nxjerr

## VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **7.285.20 €** (shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë euro e njëzet cent), për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK me Nr.15-400/01-9575 të datës 28.02.2025.
- 2.Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit 1Nr.320/01-8402 të datës 21.02.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK , sipas kostos së bashkëfinancimit të përcaktuar për vitin 2025 për Komunën e Lipjanit me qëllim të implementimit të projektit të përbashkët me titull **“Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjëve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit”**, financuar nga FRIEDA dhe zbatuar nga IADK.

### Neni 2

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK do të raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, lidhur me veprimet e ndërmarra konform dispozitave të Marrëveshjes ku përfshihet Raporti financiar lidhur me mjetet e shpenzuara dhe arsyetimi i tyre me fatura dhe dokumentacion tjetër përkatës.

### Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhironlogarinë bankare nr 2027-000021-7128-84 në TEB Bankë në emër të IADK-së.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-17654  
Lipjan, më 17.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore 15Nr.400/01-13681 i datës 24.3.2026 në zbatim të dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës” dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë 1Nr-660/03-53582 të datës 04.10.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

## VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

Më këtë Vendim, TRANSFEROHET, shuma e mjeteve në vlerë prej prej **2,848.00 €** (dy mijë e tetëqind e katërdhjetë e tetë euro ) në zbatim të dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Lipjanit, Obiliqit, Podujevës dhe Prishtinës me Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve me seli në Prishtinë 1Nr-660/03-53582 të datës 04.10.2022 si dhe Kërkesës së QMGF dërguar Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të datës 16.05.2025.

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF NGO) në nr.XK051110052260000121 në ProCredit Bank.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

1Nr. 400/01-19429  
Lipjan, më 28.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW) Nr.15-400/01-26988 të datës 29.05.2025, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-16/1-21402 të datës 28.04.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW), Kryetari i Komunes, nxjerr:

## VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **10,000.00 €** (dhjetë mijë euro), Organizatës Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW) për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW) Nr.15-400/01-26988 të datës 29.05.2025 dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-16/1-21402 të datës 28.04.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

2. Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-16/1-21402 të datës 28.04.2025 lidhur me zbatimin e projektit "Projekt i integruar për mbështetje në Shëndetësi, Arsim dhe Ekonomi Rurale në Kosovë" i cili implementohet nga Islamic Relief Kosova. Përfitues nga ky donacion do të jenë të rinjtë nga Komuna e Lipjanit ku do të përfitojnë grante për nisje të ideve biznesore.

### Neni 2

Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) do ti raportoj me shkrim Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim lidhur me veprimet e ndërmarra konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit .

### Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, kategoria për subvencione dhe transfere të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari dhe transferohet në xhironlogarinë bankare nr.1708200008014285 në NLB Banka të IRW.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-17181  
Lipjan, më 14.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , Strategjisë për Avancimin e të drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2025-2026 si dhe neneve 9, 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar edhe në Shkresën e MAPL-së Nr 0-231 të datës 30.03.2026 , Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES  
NË KOMUNËN E LIPJANIT

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim themelohet Komiteti komunal veprues në Komunën e Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës, Kryesues
2. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
3. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
4. Albert Mustafa , Shef i Sektorit DSHPS dhe zyrtar përgjegjës nga fusha e banimit, anëtar
5. Lidija Jovanovic, Zyra Lokale për Komunitete
6. Fjolla Ibrahimimi , QPS dhe Zyrtare për mbrojtjen e fëmijës
7. Linda Shahini , Zyra për barazi gjinore
8. Shahadije Ibrahimimi, Udhëheqëse e Sektorit për Buxhet dhe Financa
9. Rialda Avdi –OJQ, “Initiative for Integratione and Equality, anëtare
10. Fatlum Kryezi – OJQ- “Roma Versitas Kosova-RUK”, anëtar
11. Anita Limani OJQ “Vorae”, anëtare

## Neni 2

### Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit komunal veprues

1. Komiteti komunal veprues kryen detyrat dhe përgjegjësitë konform Strategjisë për Avancimin e të drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2025-2026 dhe do të shërbejë edhe si strukturë mbështetëse lokale për kordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit/Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të procesit të zbatimit të strategjisë.

2. Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit ka paraparë detyrat dhe përgjegjësitë specifike në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të strategjisë për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë , për Pikat e Kontaktit , si dhe për Komunitete Komunale Vepruese në nivelin lokal.

## Neni 3

### Koordinatori i Komitetit Komunal veprues

Kordinator i Komitetit Komunal veprues për Komunën e Lipjanit do të jetë :  
**Lulzim Qerimi** , Zyrtar në Zyrën Lokale për Komunitete.

## Neni 4

### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit, Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit Komunal Veprues.

1Nr. 020/04-19872

Lipjan, më 30.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

### VENDIM

#### PËR THEMELIMIN E EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË KOMUNËN E LIPJANIT

I. Me këtë Vendim, THEMELOHET, Ekipi për të drejtat e fëmijëve në Komunën e Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, kryesues i Ekipit
2. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, zëvendës kryesues i Ekipit
3. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
4. Albert Mustafa, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
5. Burim Rrustemi, Drejtor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
6. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, anëtar
7. Daut Azemi, Kryesues i komitetit për politikë dhe Financa, anëtar
8. Alush Bikliqi, Kryesues i komitetit për komunitete, anëtar
9. Fjolla Ibrahim, Zyrtare për Mbrojtjen e fëmijëve-QPS, anëtare
10. Emin Shala, policia- Lipjan, anëtare
11. Zyrafete Mavriqi Bytyqi, Qendra për punë Sociale, anëtare
12. Bekim Krasniqi ,përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar

II.Ekipi për të drejtat e fëmijëve do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me dispozitat e Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.

III.Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet

Kryesuesit zëvendës kryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të ekipit

INr. 020/04-17775  
Lipjan, më 20.04.2026

IMRI AHIMETI  
Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Listës përfundimtare të përfituesve të spërkatëseve të publikuara nga Komisioni me Nr.12-320/01-68923 e datës 19.12.2025, duke u bazuar edhe në kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari 01-320/01-19845 të datës 29.04.2026, Kryetari i Komunës nxjerr:

### VENDIM

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN E SPËRKATESEVE PËR FERMERË TË KOMUNËS SË LIPJANIT 1Nr.320/01-68405 TË DATËS 19.12.2025

##### Neni 1

1. Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet neni 1 i Vendimit për ndarjen e spërkatëseve për fermerë të Komunës së Lipjanit 1Nr.320/01-68405 të datës 19.12.2025 duke u bazuar edhe në kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari 01-320/01-19845 të datës 29.04.2026 për shkak të tërheqjes së përfituesit nga marja e subvencionit- spërkatëses .

2. Neni 1 i vendimit ndryshohet te pjesa tabelare në numrin rendor 50 ku përfituesi Valmir Mehmetali Krasniqi nga fshati Smallushë i cili ka hjekur dorë nga subvencionit- spërkatësja Zëvendësohet nga aplikuesi i radhës në listë :

**Adem Ismajl Mustafa nga fshati Babush i Muhaxherëve**

##### Neni 2

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe përfituesit të spërkatëses do të përcaktohen më detajisht në Marrëveshjen e cila do të lidhet në mes Kryetarit të Komunës dhe fermerit.

##### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Bujqësi, dhe Pylltari, Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

##### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen Zyrtare të Komunës.

1Nr. 320/01-68405/2  
Lipjan, më 29.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 duke u bazuar në Kërkesën e Drejtoratit për Arsim Nr.01-670/01-20039 të datës 30.04.2026, Kryetari i Komunes nxjerr:

### VENDIM

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 1NR.400/01-2953 TË DATËS 22.01.2026 PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSAVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2025/2026**

#### Neni 1

Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet neni 1 i Vendimit 1Nr. 400/01-2953 i datës 22.01.2026 për caktimin e bursave dhe shumës financiare për një bursë përkatësisht shtohet edhe pesë (5) bursa nga 400 (katërqind) bëhen 405 (katërqind e pesë) duke u bazuar në Shkresën e Drejtoratit për Arsim Nr. Nr.01-670/01-20039 të datës 30.04.2026. Pas plotësimit dhe ndryshimit neni 1 i Vendimit 1Nr.400/01-2953 i datës 22.01.2026 për caktimin e bursave dhe shumës financiare për një bursë, riformulohet si vijon:

**Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2025/2026 të ndahen 405 (katërqind e pesë) bursa dhe shuma financiare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.**

#### Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

1Nr. 400/01-2953/2  
Lipjan, më 30.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

**Neni 1**  
**Përbërja**

Formohet Komisioni për monitorimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale, në këtë përbërje:

1. Hazbi Ademi, Zyra e Kryetarit-Spektori për çështje pronësore-juridike, Kryesues
2. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
3. Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
4. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

1. Monitorimi dhe mbikqyrja e zbatimit të kontratave që jepen nga komuna për shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse.
2. Komisioni është i obliguar ti raportoj Kryetarit të Komunës me shkrim në baza gjashtë (6) mujore mbi mënyrën e shfrytëzimit afatëgjatë të pronës komunale nga ana e shfrytëzuesve. Raporti i parë përfshin periodën janar-qershor ndërsa Raporti i dytë përfshin periodën korrik –dhjetor për secilin vit përkatës .
3. Punët teknike administrative për komisionin do të kryhen nga Spektori për çështje pronësore-juridike dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.
4. Mandati i Komisionit është tre (3) vjeçar.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

1. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit 1Nr.020/01-2387 i datës 11.01.2024.

1Nr. 020/04-15413

Lipjan, më 02.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

#### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË LOKALEVE AFARISTE DHE ZYREVE NË PRONËSI TË KOMUNËS

I. Formohet Komisioni për monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve dhe zyreve në pronësi të Komunës, në këtë përbërje: ( në vazhdim të tekstit Komisioni)

1. Hazbi Ademi, Sektori pronësor – juridik, Kryesues
2. Abedin Bajrami, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
3. Edona Lekaj Hoxha, sektori pronësor – juridik anëtare

II. Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi që:

- Të monitoroj zbatimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe zyreve në pronësi të Komunës.
  - Të bashkëpunoj me Sektorin pronësor juridik dhe Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim për të vërtetuar se a është bërë pagesa e qirasë brenda afatave të përcaktuara me kontratë si dhe a janë përmbushur obligimet kontraktuese.
  - Komisioni është i obliguar që të dalë në teren te secili lokal afarist ose zyre me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike.
  - Punët teknike administrative për komisionin do të kryhen nga Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.
1. Komisioni ka mandat (3) trevjeçar dhe përgaditë raport me shkrim në baza gjashtë mujore për Kryetarin e Komunës mbi mënyrën e shfrytëzimit afatshkurtër të lokaleve dhe zyreve në pronësi të Komunës. Raporti i parë përfshin periodën janar-qershor ndërsa Raporti i dytë përfshin periodën korrik –dhjetor për secilin vit përkatës.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe zyreve në pronësi të Komunës 1-361/03-27711 i datës 30.05.2022 dhe Vendimi për plotësimin e përbërjes së Komisionit për monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe zyreve në pronësi të Komunës 1-361/03-27711/2 i datës 16.06.2022.

1Nr. 020/04-15417  
Lipjan, më 02.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 , Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, **Bekim Zaskoku**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të OJQ-ve përfituese të subvencioneve sipsas Thirrjes Publike për mbështetje Financiare për Aktivitete të Organizatave Joqeveritare në fushen e Sportit "Nr.05-453/01-40815 të datës 05.08.2025 , të shpallur nga Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të-klubet sportive të cilat duhet të monitorohen nga zyrtari përgjegjës i cekur më lartë .

Nr.	Emërtimi i OJQ-së)
1.	K.V "Skenderbeu"
2.	K.F" Arbëria"
3.	K.F "Gadimja"
4.	K.F "Ulpiana 1992"

**Neni 2**

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të OJQ-ve përfituese të subvencioneve , konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Bekim Zaskoku dhe Drejtorati për Kultur,Rini dhe Sport.

1Nr. 030/01-15236

Lipjan, më 01.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 14 Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 duke u bazuar edhe në kërkesën Komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa të studentëve Nr. 01-020/04-15233 të datës 01.04.2026, Kryetari i Komunës merr !

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E ANËTARES REZERVË TË KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E**  
**ANKESAVE TË STUDENTËVE PËR BURSA DHE VAZHDIMIN E AFATIT PËR**  
**SHQYRTIM**

I. Me këtë Vendim, **Caktohet MEDINA BUBLICA**, si anëtare rezervë e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të studentëve për ndarjen e bursave dhe njëkohësisht **VAZHDOHET** afati për shqyrtimin ankesave nga Komisioni përkatësisht afati për shqyrtimin e ankesave nga Komisioni vazhdohet më së shumti deri me datën **24.04.2026** duke u bazuar edhe në kërkesën Komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa të studentëve të datës 01.04.2026.

II. Zyrtarja e cekur në pikën I e caktuar si anëtare rezervë do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me detyrat e përcaktuara në Vendimin 1Nr.020/04-14123 të datës 26.03.2026 të Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit për vitin akademik 2025/2026, vetëm në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e rregullt të Komisionit ka konflikt interesi apo mungon për shkaqe të arsyeshme.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Medina Publica
- Liridon Dulahu, Kryesuesi Komisionit
- Drejtoratit për Arsim

1Nr.020/04-15233  
Lipjan, më 01.04.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

